




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Primijsena/Prodato Received / Delivery	26-09-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Bj. Pict Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHIK	5686	2022	117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.673/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi - anëtarë, me Zyla Millaku Gojnovci -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses,ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.673/2022 të datës 28.07.2022 të parashtruar nga ankuesja _____ përmes avokatit _____ me adresë, _____ në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike” kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.673/2022 e datës 28.07.2022 e parashtruar nga ankuesja _____
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.Ref: 457 i datës 14.07.2022 me numër protokolli 2691 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Vendimi me Nr.Ref.238/2022 i datës 20.07.2022 i Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pozitën Zyrtare e lartë për Këshillin Evropian dhe Evropën Jugore sipas Akt emërimit të datës 23.12.2013, me Vendimin më numër ref.636/2018 të datës 23.07.2018 të Zëvendëskryeministrit të parë /Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), i ipet grada diplomatike Ministër Këshilltar dhe caktohet të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër /Mbretëria e Bashkuar me mandat katër (4) vjeçar, duke filluar nga data 01.10.2018.

Me notën verbale të datës 13.01.2020 me nr.ref.ZDP 10/2020 të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, njoftohet Protokollin Shtetit për Punë të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar se [redacted] do shërbej si e ngarkuar me punë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar. Ankuesja me Vendimin me numër ref.26/2021, të datës 16.04.2021, të Ministres të MPJD-së me gradën Ministër-Këshilltare emërohet e ngarkuar me punë të përkohshme, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretëria e Bashkuar.

Me datën 08.04.2022 Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, merrë Vendim me numër Nr.Ref.201/2022, sipas të cilit ankuesen e kthen/tërheq nga misioni diplomatik Minister Këshilltare, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar, nga data 30.04.2022,ndërsa përmes Vendimit nr.ref:152/2022 të datës 11.05.2022 e njehta përkohësishtë sistemohet në pozitë të Zyrtarës së Lartë për Mardhënie Shumëpalëshe në Divizionin për Amerikën Veriore në Departamentin për Amerikë-MPJD.

Ankuesja e pakënaqur me këtë vendim me datën 06.05.2022 përmes përfaqësuesit të saj, ka parashtruar ankesë me numër protokollin 2641/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili me datën 19.05.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datën 26.05.2022, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë prej 1/28 faqe, me numër protokollin 3053/2022.

Me datë 27.06.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin Anr.441/2022 me numër protokollin 3755/2022, me të cilin e ka shfuqizuar Vendimin me numër Nr.ref: 201/2022 të datës 08.04.2022 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministrës së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke obliguar Zëvendës Kryeministren dhe Ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndërmarrë veprimet procedurale për ta rishqyrtuar lëndën e ankueses [redacted] prej afatit 15 ditësh.

Përmes vendimit Nr.Ref:457 të datës 14.07.2022 dhe të protokoluar me nr.ref: 2691 datë 15.07.2022 ZëvendësKryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerre Vendimin bazuar në Vendimin A.nr.441/2022 të datës 27. 06.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin vendim përmes pikës 1 të këtij vendimi ka shfuqizuar pikën 2 të vendimit nr.ref.636/2018 të datës 23/07/2018 të Ministrit të Punëve të Jashtme për caktimin e ankueses që të shërbej në ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretëria e Bashkuar si dhe vendimin nr.ref.26/2021 të datës 16/04/2021,me që rastë përmes këtij vendimi e njehta është kthyer nga misioni,njëkohësishtë duke e obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ta sistemoj në mënyrë të përhershme brenda MPJD-së,ndërsa përmes Vendimit Nr.ref:238/2022 të datës 20.07.2022, i protokolluar me numër 2820 datë 25/07/2022 ankuesja është sistemuar në pozitë: "Zyrtare e Lartë për Marrëdhënies Shumëpalëshe" në Divizionin për Amerikën Veriore në Departamentin për Amerikë-MPJD, duke filluar nga data 20/07/2022.

Kundër Vendimit me numër reference: 457/2022 të datës 14.07.2022 të Zëvendës Ministres së Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesja [redacted] përmes përfaqësuesit të autorizuar të saj, më datë 28.07.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me nenin 47 dhe 52 paragrafin 1, nënparagrafin 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke i propozuar Këshillit që të nxjerrë vendim dhe ta aprovoj

ankesën në tërës si të bazuar, të anulohj Vendimin me Nr. Ref:457/2022 të datës 14.07.2022 dhe të obligojë Zëvendëskryeminstren dhe Ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që ankuesen ta kthej në pozitën e mëparshme sipas Vendimit Nr.ref: 636/208 të datës 23.07.2018 të Zëvendëskryeminstrit të parë- Ministrit të Punëve të Jashtme, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës duke e kompensuar diferencën e pagës në mënyrë retroaktive nga data e kthimit të saj nga misioni (dt.30.04.2022) deri në zbatimin e plotë të këtij vendimi.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 09.09.2022 ka nxjerr vendimin VK.nr.92/2022 për shtyrje të afatit edhe për 10 (dhjetë) ditë punë të ankesës A.nr.673/2022 të datës 28.07.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritohor ka administruar këto prova: Ankesën, A.nr.673/2022 të datës 28.07.2022 me numër protokolli 4374/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi datës 23.12.2013; Vendimi i datës 23.06.2018; Nota verbale Ref/ZDP/10/2020 e datë 13.01.2020; Vendimi nr.ref.26/2021 i datës 16.04.2021; Vendimi nr.protokolli 1273 i datës 08.04.2022; Ankesa e datës 06.05.2022 me nr.protokolli 2641/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 27.06.2022 A.nr.441/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 15.07.2022 nr.protokolli 2691; Autorizimi i datës 18.07.2022; Vendim i datës 15.06.2022 për vazhdim të afatit nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 04.05.2022; Përgjigje në ankesë e datës 26.05.2022 me nr. Protokolli 3053/2022 prej 1/28 faqe; Kërkesa për përgjigje e datës 19.05.2022 me fletë-kthesë të datës 19.05.2022; Vendim nr.44/09 i datës 23.11.2009 për emërimin Konsulle [redacted] në Mbretërinë e Suedisë; Vendimi nr.ref:461/2013 i datës 23.08.2013 për emërimin e [redacted] -Konsulle në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Suedisë; Vendim me numër: ZSP/288/13 i datës 20.12.2013, për caktimin e [redacted] në mënyrë të përhershme në pozitë: Zyrtare e lartë për Këshillin Evropian dhe Evropën Jugore në Departamentin për Evropë dhe BE-së në MPJ; Vendimin nr.1594/2022 i datës 11.05.2022 për sistemim të përkohshëm; Vendimi nr.ref:238/2022 i datës 20.07.2022 për sistemim të përhershëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e pabazuar, **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar pretendimet e ankueses kundër Vendimit me numër reference: 457/2022 të datës 14.07.2022 të Zëvendës Kryeminstres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, i nxjerrë duke ju referuar edhe zbatimit të Vendimit A.nr.441/2022 të datës 27.06.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ka theksuar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me nenin 47 dhe 52 paragrafin 1, nën paragrafin 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, duke pretenduar që të kthehet në pozitën e mëparshme sipas Vendimit Nr.ref: 636/208 të datës 23.07.2018 të Zëvendës Kryeminstrit të parë dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës duke e kompensuar diferencën e pagës në mënyrë retroaktive nga data e kthimit të saj nga misioni (dt.30.04.2022) deri në zbatimin e plotë të këtij vendimi.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës

23.12.2013 është emëruar në pozitën *Zyrtare e lartë për Këshillin e Evropian dhe Evropën Jugore*, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, të cilës me datë 23.07.2018 i ipet grada diplomatike Ministër Këshilltar me Vendimin Nr.636/2018, e cila përmes këtij vendimi njëkohësisht është caktuar të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar, me mandat katër (4) vjeçar. Me datë 16.04.2021 Zëvendës Kryeministrja dhe Ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerrë Vendimin me Nr.Ref.26/2021, me të cilin ankuesen e emëron të ngarkuar me punë të përkohshme, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar, ndërsa me datë 08.04.2022 Zëvendës Kryeministrja dhe Ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nxjerrë Vendim me numër Nr.Ref.201/2022, me të cilin ankuesen e kthen/e tërheq nga misioni diplomatik e emëruar Minister Këshilltar, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar, nga data 30.04.2022, ndaj të cilit vendim ankuesja ka parashtruar ankesë me datë 06.05.2022 përmes përfaqësuesit të saj, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili me datë 27.06.2022 ka nxjerrë Vendimin A.nr.441/2022 me të cilin e ka shfuqizuar Vendimin me numër Nr.Ref.201/2022 të datës 08.04.2022 dhe e ka obliguar Zëvendës Kryeministren dhe Ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që brenda afatit prej 15 ditësh, të rishqyrtoj lëndën e ankueses që të ndermarr të gjitha veprimet procedurale ligjore.

Me datë 15.07.2022, Zëvendës Kryeministrja dhe Ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, konform kompetencave ligjore, ka zbatuar Vendimin A.nr.441/2022 të Këshillit duke nxjerre Vendimin Nr.ref:457 të protokolluar nr.2691, me të cilin: në pikën I, ka shfuqizuar Vendimin Nr.ref: 636/208 e datës 23.07.2018 të Zëvendës Kryeministrit të parë Ministër i Punëve të Jashtme dhe Vendimin me Nr.Ref.26/2021 të datës 16.04.2021 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pikën II, ankuesen e tërheqë/e kthen nga misioni diplomatik në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar, dhe në pikën III të këtij vendimi, ankueses i siguron sistemim të përhershëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD-së deri me datë 20.07.2022, të nxjerret vendimi në lidhje me këtë qështje. Më pas me datë 20.07.2022 Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së sipas obligimit ligjor, ka nxjerrë Vendimin Nr.ref:238/2022 i protokolluar 2820 datë 25/07/2022, me të cilin ankuesen e ka sistemuar në mënyrë të përhershme në pozitë "*Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie Shumëpalëshe në Divizionin për Amerikën Veriore*", në Departamentin për Amerikë në MPJD, duke filluar nga data 20.07.2022 realizimi i detyrave dhe përgjegjesive të saj sipas këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses sa i përket shkeljes së dispozitave materiale sa i përket kësaj qështje dhe bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se Zëvendës Kryeministrja dhe Ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.Ref: 457 i datës 14.07.2022 i protokolluar më datë 15/07/2022 dhe me numër protokollit 2691, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.Ref:457/2022 i datës 15.07.2022 i nxjerrë nga Zëvendës Kryeministrja dhe Ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është bërë në pajtim me dispozitat e cekura si më lartë .

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që vendimi është nxjerrë me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale, konkretisht në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm Nr.03/L-122, Ligjin për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114, Rregulloren Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm të plotësuar me rregulloren Nr.04/2014 dhe Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës konstaton se ankuesja sipas Vendimit me numër ref.26/2021 të datës 16.04.2021 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është ngarkuar me punë

të përkohshme me gradën Ministër-Këshilltare, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër, dhe referuar shkresave të lëndës dhe bazuar në vendimin e mësipërm sipas nenit 16 paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: "2. I ngarkuari me punë i përkohshëm emërohet nga Ministri i Punëve të Jashtme" që nënkupton se përgjegjësia është ekskluzive Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diaspores për caktimin në pozitë të përkohshme sipas paragrafit 2 të nenit 16 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës ndërsa sipas Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm përkatësishtë nenit 10 paragrafi 8 dhe 9 parashihet: "8. Kohëzgjatja në detyrë për zyrtarët e angazhuar në shërbim jashtë vendit mund të ndryshoj sipas nevojave të shërbimit ose për shkakë të rrethanave detyruese personale..." dhe nenin 9: "Ministria ka autoritetin të ndryshoj standardet e kohëzgjatjes së shërbimit varësishtë nga kushtet e vendit të misionit ose nevojat e shërbimit", dhe mbi këtë bazë ligjore konstatohet se është kompetencë diskrecionale e Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diaspores që varësishtë nga interesi i institucionit të ndërmarrë veprime konformë këtyre dispozitave ligjore të specifikuara më lartë, dhe që nënkupton se bazuar në këto dispozita Vendimi me Nr. Ref: 457 i datës 15.07.2022 me numër protokollit 2691 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është në harmoni me nenin 22 dhe 23 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar në nenin 22 se: "Përfaqësuesit diplomatik qëndrojnë në shërbim në të njëjtin mision diplomatik për një periudhë katër(4) vjeqare, ose ndryshe siq kërkohet për të përmbushur nevojat e Ministrisë dhe në diskrecion të Ministrit të Punëve të Jashtme" ndërsa në nenin 23 paragrafi 2 parashihet "Tërheqja e të gjithë përfaqësuesve të tjerë diplomatikë, duke mos e përfshirë shefin e misionit, për të njëjtat arsye të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, bëhet me urdhërin e Ministrit të Punëve të Jashtme" dhe Vendimi me Nr. Ref. 238/2022 i datës 20.07.2022 i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është i bazuar në legjislacionin e të drejtës materiale të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe njëkohësishtë drejtë është konstatuar edhe gjendja faktike dhe mbi këto baza pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave sa i përket pretendimit ankimor sa i përket aspektit të së drejtës procedurale konstaton se përmes vendimit të datës 15.07.2022 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e zbatimit të Vendimit A.nr.441/2022 të datës 27.06.2022 të Këshillit, janë marrë për bazë dispozitat ligjore të nenit 53 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe ka nxjerrë Vendimin Nr.ref:457 të protokolluar me numër 2691, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin Nr. Ref:636/208 të datës 23.07.2018 të Zëvendës Kryeministrit të parë Ministër i Punëve të Jashtme, me të cilin ankueses i ipet grada diplomatike Minister/Këshilltare dhe Vendimin me Nr. Ref.26/2021 e datës 16.04.2021 të Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me të cilin ankuesja caktohet përkohësisht në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër, bazuar në dispozitat e lartë cekura, ku është e përcaktuar se: "1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm. 3. Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë", mbi këtë bazë është konstatuar se Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi që atakohet me këtë ankesë ka vepruar drejtë sa i përket procedurave në lidhje me këtë çështje.

Kurse sa i përket pretendimeve të tjera të ankueses që lidhen me kthimin në pozitën e mëparshme sipas Vendimit Nr.ref: 636/208 të datës 23.07.2018 të Zëvendës Kryeministrit të parë dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, kolegji konstaton se janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara në legjislacionin në fuqi të MPJD-së nga arsyet që u potencuan më lartë nga se e njejta për arsye dhe nevojë të punës së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, siç e ka përcaktuar neni 22 dhe 23 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, është tërheq për të shërbyer brenda MPJD-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhje me pretendimin ankimor që ti bëhet kompensimi i diferencës së pagës në mënyrë retroaktive nga data e kthimit të saj nga misioni (dt.30.04.2022) deri në zbatimin e plotë të këtij vendimi, kolegji konstaton se është i pabazuar ky pretendim sepse ankuesja nga fillimi i muajit maj përkatësishtë data 04/05/2022 është sistemuar përkohësishtë në pozitë: *"Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie Shumëpalëshe në Divizionin për Amerikën Veriore"*, në Departamentin për Amerikë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sipas Vendimit Nr. Ref:152/2022 të datës 11.05.2022 të nxjerrë nga zv.Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe poashtu për diferencën e pagës së mbetur nga misioni i përfunduar diplomatik nga data 30.04.2022 deri më datë 04/05/2022, ankuesja me asnjë prove nuk e ka dëshmuar se ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit respektivishtë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur me kompensimin e diferencës së pagës së pa paguar, siç e përcakton dispozita ligjore të nenit 74 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, konform Vendimit Nr.ref:457 të datës 14.07.2022 e të protokoluuar më datë 15/07/2022 me nr.prot.2691 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 20/07/2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.Ref:238/2022 të protokoluuar më datë 25.07.2022 me nr.prot.2820, me të cilin ankuesen e ka sistemuar në mënyrë të përhershme në pozitën *"Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie Shumëpalëshe në Divizionin për Amerikën Veriore"*, në Departamentin për Amerikë në MPJD, duke filluar me ushtrimin e përgjegjësive sipas këtij vendimi nga data 20.07.2022, në këtë mënyrë ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 4 paragrafin 2 nën paragrafin 2.5 e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publik, që përcaktohet se: *"2.Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve"*, lidhur me nenin 23 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe paragrafin 2 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili vendim sipas kolegjit të këshillit është në harmoni me dispozitat e nenit 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.673/2022, datë 26.09.2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtarë e Lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së